


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6819
E martë, 7 shkurt 2023
çmimi 0.40 €

Lansohet platforma
"superpuna",
synohet punësimi
i 10 mijë të rinjve | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DHJETËRA TËRMETE TË FUQISHME KANË GODITUR TURQINË DHE SIRINË | FAQE 4-5

MIJËRA TË VDEKUR E TË LËNDUAR, QINDRA NDËRTESA TË SHKATËRRUARA NGA TËRMETI I FUQISHËM NË TURQI



Mijëra persona të vdekur dhe të lënduar në Turqi dhe Siri ka shkaktuar një tërmet i fuqishëm prej 7.8-ballësh që ka goditur juglindjen e Turqisë në orët e hershme të 6 shkurtit. Epiqendra e tërmetit ishte afër qytetit

turk Gaziantep. Pas këtij tërmeti kanë pasuar edhe tërmete të tjera me 7.7 dhe 6.7 rihter. Raportohet se numri i viktimave mund të rritet edhe më tutje derisa ekipet e shpëtimit po vazhdojnë kërkimin e të mbijetuarve

që kanë mbetur të bllokuar nën rrënoja pas rrëzimit të ndërtesave. Pas këtyre tërmeteve bota u ka ofruar ndihmë Turqisë dhe Sirisë. Ndihmës për Turqinë i janë bashkuar edhe Kosova dhe Shqipëria

AKTUALE



NORVEGJIA JEP NDIHMË PËR UKRAINËN 7 MILIARDË DOLLARË | F.2

BËRNABIQI KËRKON FALJE QË KOSOVA U CILËSUA REPUBLIKË: NUK KAM FJETUR TËRË NATËN | F.7

VITIA KOORDINOHET ME PARTNERËT E RËNDËSISHËM NË SEKTORIN E SHËNDETËSISË | F.7

EKONOMI



DHOMA E TREGTISË EMËRON DREJTORESHËN EKZEKUTIVE | F.6

SHQIPËRIA PRET RITJE TË NDIKIMIT TË KINËS NË EKONOMI | F.6

SPORT



PREMTOHET FESTË E BASKETBOLLIT NË RAHOVEC | F.10

LAJÇAKU INFORMOHET NGA KURTI PËR GJASHTË KUSHTET, E KËRKON MARRËVESHJEN PËR ASOCIACIONIN

| FAQE 3



KUVENDI TË ENJTEN SHOYRTON KOEFICIENTIN E PAGAVE, OPOZITA KËRKON QË VLERA TË JETË 120 EURO | FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Norvegjia jep ndihmë për Ukrainën 7 miliardë dollarë

OSLO, 6 SHKURT - Kryeministri i Norvegjisë, Jonas Gahr Stoere, ka propozuar që shteti i tij, një prej eksportuesve më të mëdhenj të karburanteve, t'i ofrojë ndihmë Ukrainës në vlerë prej 7.3 miliardë dollarësh në një periudhë pesëvjeçare. "Ne synojmë të arrijmë një marrëveshje të unifikuar për këtë temë në Parlament", tha për gazetaret kryeministri norvegjez, Jonas Gahr Stoere pas takimit me liderët e opozitës. Ky shtet nordik ka përjetuar rritje rekorde të të ardhurave pas nisjes së pushtimit rus të Ukrainës pasi sasia e gazit e shitur në Evropë u rrit vitin e

kaluar. Stoere, që po përballet me kritika nga disa shtete dhe një pjesë e opozitës në Norvegji, se në mënyrë indirekte po përfiton nga lufta, në fund të vitit 2022 prezantoi planin që t'i ofrojë Ukrainës ndihmë shumëvjeçare. Por, atëbotë ai nuk dha ndonjë shifër sa i përket kësaj ndihme. "Më 2023 gjysma e ndihmës do t'i financojë kërkesat ushtarake, ndërkaq pjesa tjetër do të shkojë për nevoja humanitare, edhe pse ndarjet mes ndihmës ushtarake dhe humanitare mund të ndryshojnë në vitet pasuese", tha Stoere.



Ai ka theksuar se Norvegjia, po ashtu, do të japë 5 miliardë kruna shtesë gjatë këtij viti ndihmë për shtetet e varfra, të prekura nga rritja globale e çmimeve ushqimore pas pushtimit rus të Ukrainës. Qeveria e pakicës së Stoere

duhet ta kërkojë miratimin e Parlamentit për këto fonde. Kjo paketë e ndihmës pritet t'i rrisë shpenzimet vjetore të Fondit sovran të Norvegjisë, që është fondi më i pasur në botë në vlerë prej afër 1.4 trilion dollarësh. Partia kryesore opozitare, Partia Konservatore, pritet ta mbështesë planin, për të cilin do të negociojë në javët e ardhshme. Më 2022 Norvegjia u bë furnizuesja më e madhe e gazit në Evropë pas ndërprerjes së furnizimeve me gaz rus. Norvegjia është prodhuesja e dytë më e madhe në botë e naftës, pas Rusisë.

Izraeli vret pesë palestinezë gjatë një bastisjeje në Bregun Perëndimor

JERUSALEM, 6 SHKURT - Forcat izraelite kanë vrarë pesë sulmues të armatosur palestinezë gjatë një bastisjeje në një kamp refugjatësh në Bregun e pushtuar Perëndimor më 6 shkurt.

Bastisja e fundit pritet që edhe më tej t'i përshkallëzojë tensionet në këtë rajon.

Zyra e presidentit të autoritetit palestinez tha se kjo dhunë është krim, duke kërkuar nga Shtetet e Bashkuara t'i bëjnë presion Izraelit të mos vazhdojë inkursionet.

Ushtria izraelite tha se bastisja u krye me qëllim që të arrestohej një celulë militantësh që kishte kryer një sulm në një restorant në vendbanimin hebre në Bregun Perëndimor.

Dhuna e fundit vjen në një prej periudhave më vdekjeprurëse në vitet e fundit në konfliktin izraelito-palestinez dhe në javët e para të qeverisë së re izraelite, që ka premtuar se do të ketë një qasje më të ashpër ndaj palestinezëve.

Ushtria izraelite tha se po operonte në kampin e refugjatëve Akabat



Xhabër, për t'i arrestuar të dyshuarit e sulmit të muajit të kaluar në një restorant në Bregun Perëndimor. Ushtria tha se disa prej sulmuesve që u vranë ishin të përfshirë në ngjarjen e muajit të kaluar. "Qeveria e re e Izraelit po vazhdon serinë e krimeve kundër

popullit palestinez", tha zyra e presidentit palestinez Mahmoud Abbas.

Ndërkaq, Jihad Abu Al-Assal, guvernator i Jerikos në Luginën e Jordanit, tha se ushtria izraelite po mban trupat e pajetë të viktimave. Pa qasje në trupat e viktimave,

Ministria palestineze e Shëndetësisë tha se nuk mund ta konfirmojë numrin e të vrarëve, por shtoi se tre persona janë të plagosur, njëri prej tyre në gjendje kritike. Sipas burimeve të sigurisë, "Associated Press" raportoi se dy prej të vrarëve ishin anëtarë të

Hamasit, ndërkaq tre të tjerë u vranë gjatë këmbimit të zjarrit me trupat izraelite gjatë bastisjes.

Që nga pranvera e kaluar ushtria izraelite ka shpeshuar bastisjet në Bregun Perëndimor, pas një serie të sulmeve vdekjeprurëse palestineze brenda Izraelit.

Vitin e kaluar pothuajse 150 palestinezë janë vrarë në Bregun Perëndimor dhe në Jerusalem Lindor, që është numri më i lartë i viktimave në këtë zonë që nga viti 2004, kanë thënë organizatat për të drejtat e njeriut. Ndërkaq, që nga fillimi i këtij viti, 41 palestinezë janë vrarë në këto territore. Rreth 30 persona janë vrarë në Izrael nga palestinezët më 2022.

Ushtria izraelite ka thënë se shumica e palestinezëve të vrarë kanë qenë militantë.

Izraeli ka pushtuar Bregun Perëndimor, Rripin e Gazës dhe Jerusalem Lindor gjatë Luftës së Lindjes së Mesme më 1967. Palestinezët thonë se këto territore do të jenë pjesë e një shteti të tyre të pavarur në të ardhmen.

Italia jep alarmin për hakerim kompjuterësh në shkallë të gjerë

ROMË, 6 SHKURT - Mijëra sisteme kompjuterike në mbarë botën janë shënjestruar nga një sulm kibernetik, i llojit 'ransomware', që do thotë se hakerat kërkojnë para në këmbim të informacioneve të vjedhura. Lajmi u dha të dielën nga Agjencia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike e Italisë (ACN), e cila paralajmëroi për ndërmarrjen e veprimeve për t'i mbrojtur sistemet.

Sulmi kibernetik synoi të shfrytëzonte një dobësi të programeve kompjuterike, tha drejtori i përgjithshëm i

agjencisë, Roberto Baldoni, për agjencinë e lajmeve 'Reuters', duke shtuar se ai ishte një sulm i një shkalle masive.

Agjencia italiane e lajmeve ANSA, duke cituar ACN-në, njoftoi se programet kompjuterike ishin komprometuar edhe në vende të tjera evropiane si në Francë, Finlandë, Shtetet e Bashkuara e Kanada.

Zyrtarët amerikanë të sigurisë kibernetike thanë se po bënin një vlerësim të situatës pas incidenteve të njoftuara nga pala italiane. "CISA po punon me

partnerët e saj të sektorit publik dhe privat për t'i vlerësuar ndikimet e këtyre incidenteve të njoftuara e për të ofruar ndihmë aty ku është e nevojshme", ka bërë me dije Agjencia amerikane për Sigurinë Kibernetike dhe të Infrastrukturës.

Dhjetëra organizata italiane ka të ngjarë të jenë prekur dhe shumë të tjera ishin paralajmëruar të merrnin masa për të shmangur një dalje jashtë sistemeve të tyre.

Klientët e kompanisë 'Telecom Italia' njoftuan të dielën për probleme me internetin.



Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Lajçaku informohet nga Kurti për gjashtë kushtet, e kërkon marrëveshjen për asociacionin

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 6 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe i dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, kanë zhvilluar të hënën një takim në Prishtinë. Takimi, i cilësuar "drekë pune", është mbajtur në një restorant në kryeqytetin e Kosovës.

Në takimin me emisarin evropian Kurti është shoqëruar nga zëvendëskryeministri Besnik

Bislimi. Vizita e Lajçakut në Prishtinë ndodhi në kohën e rritjes së kërkesave nga faktori ndërkombëtar që Kosova ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Pas takimit me Kurtin, ka folur për medie Lajçaku, duke theksuar se me rëndësi është që të zbatohen të gjitha marrëveshjet. Lajçaku ka thënë se arsyeja e ardhjes së tij në Kosovë është çështja e planit evropian si dhe Asociacioni. Ai bëri me dije se janë përmendur gjashtë kushtet e parashtruara

nga Kurti lidhur me Asociacionin.

I pyetur për çështjen e themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ai tha se tashmë është e ditur se gjithçka që është nënshkruar, duhet të zbatohet. "Janë përmendur edhe kushtet e Kurtit. Për ne është e rëndësishme të bëhen marrëveshjet për normalizim të raporteve", ka theksuar Lajçaku. Pas qëndrimit në Prishtinë, Lajçaku ka udhëtuar për takime në Beograd.

Kryeministri Albin Kurti, të hënën, i shoqëruar nga zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, ka pritur të hënën në takim ambasadorët dhe diplomatët e akredituar të misioneve diplomatike në Kosovë. Temë qendrore e diskutimit ishte procesi i dialogut, propozimi evropian dhe rruga përpara.

Kurti i ka njoftuar ata me qëndrimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfshirë këtu edhe gjashtë pikat e

paraqitura në seancën e Kuvendit javën e kaluar në lidhje me marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013. Ndër të tjera, ai ka thënë se Kosova ka dëshmuar përkushtimin e saj për dialog përmes qasjes konstruktive dhe propozimeve kreative. Po ashtu, Kurti ka shprehur gatishmërinë e tij për takime të radhës në Bruksel të nivelit të lartë politik dhe shtim të procesit të dialogut për normalizim të plotë të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë me njohjen reciproke në qendër.



Kuvendi të enjten shqyrton koeficientin e pagave, opozita kërkon që vlera të jetë 120 euro

"Epoka e re"

PRISHTINË, 6 SHKURT - Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka deklaruar të hënën se Kryesia e Kuvendit është pajtuar për mbajtjen e dy seancave për këtë javë. Sipas Kusarit, në Kuvend të enjten shqyrtohet koeficienti për paga. "E para do të jetë më 8 shkurt, me fillim nga ora 12:00, dhe në agjendë do të jetë trajtimi i pikave të papërfunduara dhe seancave të pambyllura nga ditët e mëhershme, përfshirë edhe ato të muajit dhjetor. Ndërsa seancë e rregullt do të mbahet të enjten më 9 shkurt, me fillim nga ora 10:00, në të cilën, përveç pikave të rregullta, deklarimeve jashtë rendit të ditës, pyetjeve parlamentare dhe një mori

votimesh, të cilat janë pika të bartura, do të jetë edhe shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore, ndryshime këto të cilat do të reflektojnë miratimin e koeficientit të miratuar në qeveri nga Ligji i Pagave", ka thënë Kusari-Lila. Ajo ka bërë me dije se janë pajtuar që në javën e ardhshme të shqyrtohet raporti i Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Kosovës.

Ndërsa shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka thënë se në këtë seancë do të kërkohej ngritja e vlerës së koeficientit në 120 euro. "Besojmë se shumica do të këndellet karshi kërkesave nga sindikatat. Kërkoj që të



pajtohen me propozimet dhe të shkojë në ngritje të vlerës së koeficientit të pagave [në 120 euro]", ka theksuar Tahiri.

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e saj të fundit ka vendosur ta caktojë koeficientin e Ligjit të Pagave për punëtorët e sektorit

publik. Vlera e koeficientit për vitin 2023 do të jetë 105 euro, ndërsa për vitin 2024 pritet të jetë 110 euro.



DHJETËRA TËRMETE TË FUQISHME KANË GODITUR TURQINË DHE SIRINË

Mijëra të vdekur e të lënduar, qindra ndërtesa të shkatërruara nga tërmeti i fuqishëm në Turqi

Mijëra persona të vdekur dhe të lënduar në Turqi dhe Siri ka shkaktuar një tërmet i fuqishëm prej 7.8-ballësh që ka goditur juglindjen e Turqisë në orët e hershme të 6 shkurtit. Epiqendra e tërmetit ishte afër qytetit turk Gaziantep. Pas këtij tërmeti kanë pasuar edhe tërmete të tjera me 7.7 dhe 6.7 rihter. Raportohet se numri i viktimave mund të rritet edhe më tutje derisa ekipet e shpëtimit po vazhdojnë kërkimin e të mbijetuarve që kanë mbetur të bllokuar nën rrënoja pas rrëzimit të ndërtesave. Pas këtyre tërmeteve bota u ka ofruar ndihmë Turqisë dhe Sirisë. Ndihmës për Turqinë i janë bashkuar edhe Kosova dhe Shqipëria

Osmanije, Adijamana, Malatia, Shanliurfa, Adana, Dijarbakiri dhe Kilisi.

Ministria e Shëndetësisë e Sirisë ka njoftuar se 237 persona kanë vdekur në provincat e kontrolluara nga qeveria, në Alepo, Hama dhe Tartus, ndërkaq më shumë se 600 persona të tjerë janë lënduar.

Në Siri, sipas autoriteteve të atjeshme, nga tërmeti janë goditur provincat Alepo, Latakia, Hama dhe Tartus.

Turqia gjendet mbi një nga linjat

më të mëdha sizmike dhe shpesh goditet nga tërmetet.

Epiqendra e tërmetit të së hënës ishte rreth 26 kilometra nga qyteti Nurdagi dhe rreth 33 kilometra larg qytetit Gaziantep, ka njoftuar Shërbimi Gjeologjik amerikan. Ka pasur edhe tërmete pasuese, përfshirë edhe një në shkallë prej 6.7-shkallësh të Rihterit.

Në të dy shtetet po zhvillohen operacione për t'i shpëtuar njerëzit e bllokuar nën rrënoja pas rrëzimit të ndërtesave. Në të dyja anët e kufirit banorët ishin

në gjumë kur goditi tërmeti dhe ata dolën jashtë në mot të ftohtë, me borë dhe shi, teksa ndërtesat u rrëzuan.

Në banor i qytetit turk, Adana, tha se tri ndërtesa pranë shtëpisë së tij kolapsuan. "Nuk kam fuqi më", është dëgjuar të ketë thënë një prej të mbijetuarve, i bllokuar nën rrënoja, teksa ekipet e shpëtimit kanë bërë përpjekje që ta shpëtojnë, tha banori i Adanit, Muhammet Faith Yavus.

Në anën siriane të kufirit, tërmeti goditi rajonet e kontrolluara nga

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

ANKARA, 6 SHKURT - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka thënë të enjten se vetëm në shtetin e tij janë regjistruar 912 viktima, ndërkaq Siria raportoi për 783 të vdekur. Tërmeti prej 7.8 shkallësh të Rihterit goditi të hënën juglindjen e Turqisë dhe veriu e Sirisë.

Agjencia për menaxhimin e emergjencave raportoi se të hënën u regjistrua edhe një tërmet i ri prej 7.6-ballësh afër epiqendrës së tërmetit paraprak vdekjeprurës, duke shkaktuar dridhje të tjera të tokës.

Presidenti turk tha më herët se 500 persona janë lënduar,

ndërkaq 2 470 të tjerë janë nxjerrë nga rrënojat.

"Afër 3 000 ndërtesa janë rrëzuar nga tërmeti", tha ai. "Për shkak se heqja e rrënojave po vazhdon në shumë ndërtesa që gjenden në zonën e tërmetit, ne nuk e dimë se sa do të rritet numri i të vdekurve dhe të plagosurve", tha Erdogan.

Ai tha se ka pranuar ndihmë nga rreth 45 shtete të botës.

Afër 9 000 persona po marrin pjesë në operacionet e shpëtimit. Edhe zyrtarët në Siri kanë raportuar, po ashtu, për mijëra persona të lënduar.

Sipas autoriteteve të Turqisë, dhjetë qytete turke janë prekur nga tërmeti. Ato janë: Gaziantepi, Kahramanmarashi, Hatai,





opozita, ku jetojnë afër 4 milionë të zhvendosur nga pjesë të tjera të Sirisë për shkak të luftës civile në vend. Shumica prej tyre jetojnë në kushte të rënda dhe pa përkujdesje shëndetësore tekta territoret ku gjenden ata janë të rrethuara nga forcat siriane. Autoritetet turke thanë se pas tërmetit të parë të fuqishëm janë regjistruar edhe të paktën 20 lëkundje të tjera pasuese.

Bota ofron ndihmë për Turqinë dhe Sirinë

Pas tërmetit në Turqi dhe Siri, qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare kanë ofruar ndihmë për këto dy shtete. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se anëtarët e aleancës po mobilizojnë mbështetjen për ta ndihmuar Turqinë pas tërmetit shkatërrues. Rusia tha se dy avionë IL-76 dhe 100 pjesëtarë të ekipeve të shpëtimit janë të gatshëm të shkojnë në Turqi nëse është e nevojshme. Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, u ka dërguar mesazhe liderëve në Turqi dhe Siri, duke u ofruar ndihmë. Ndërkaq, presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, po ashtu u shpreh i gatshëm të dërgojë ndihmë. "Në këtë moment ne jemi afër me popullin mik të Turqisë dhe të gatshëm ta ofrojmë ndihmën e nevojshme", tha Zelensky. Ndihmë me ekipe të zjarrfikësve dhe qen të shpëtimit premtoi

Polonia, por edhe India. Greqia tha se po mobilizon burimet e ndihmës që do të dërgohen shpejt në Turqi, ndërkaq Spanja pohoi se ekipet urbane të shpëtimit janë të gatshme të dërgohen menjëherë në zonat ku ka nevojë. Izraeli tha se autoritetet janë duke bërë përgatitjet për të ofruar ndihmë mjekësore dhe të kërkim-shpëtimit, ndërkaq Tajvani ka ofruar një ekip prej 130-zjarrfikësish, por edhe të qenve kërkues dhe 13 tonë ndihma për Turqinë. Turqia, ku ishte epiqendra e tërmetit, shpesh goditet nga tërmete të fuqishme. Disa besojnë se ky ishte tërmeti më i madh që ka goditur Turqinë. Sizmologu nga Longond College, Stephen Hicks, tha se edhe një tërmet prej 7.8-shkallësh kishte goditur Turqinë më 1939, duke vrarë 30 000 persona.

BE-ja aktivizon ndihmën emergjente për Turqinë

Komisioni Evropian ka njoftuar se me kërkesë të Turqisë, pas tërmetit të rëndë që ka goditur vendin, ka aktivizuar mekanizmat emergjentë të unionit për mbrojtje civile. Një tërmet prej 7.8-shkallësh të Rihterit goditi të hënën juglindjen e Turqisë dhe veriun e Sirisë. Nga tërmetet e fuqishme në Turqi janë vrarë mbi 900 persona, ndërsa në Siri rreth 800. Komisionari evropian për

Menaxhimin e Krizave, Janez Lenarčič, tha përmes një deklarate se Bashkimi Evropian ka angazhuar menjëherë ekipet për kërkimin dhe gjetjen e personave që mund të jenë nën gërmadhat e ndërtesave të rrënuara. Sipas njoftimit, dhjetë ekipe për "kërkim urban" janë mobilizuar menjëherë në Bullgari, Kroaci, Çeki, Francë, Greqi, Hungari, Maltë, Holandë, Poloni dhe Rumani për t'u dalë në ndihmë shërbimeve turke në kërkim të personave që kanë pësuar nga tërmeti. Ndërsa Italia, Spanja dhe Sllovakia i kanë vënë në dispozicion ekipet e tyre për Turqinë. Qendra koordinuese e BE-së për reagime emergjente ka vendosur kontakte me autoritetet e Turqisë dhe thuhet se sipas nevojës do t'i koordinojnë veprimet. Edhe sistemi satelitor i BE-së, Copernicus, është aktivizuar dhe po ndihmon në identifikimin e pozicioneve të goditura. Në komunikatën e BE-së thuhet se unioni shpreh gatishmërinë që t'u ofrojë ndihmë edhe pjesëve të Sirisë të cilat janë goditur këtij tërmeti. "Ndajmë dhimbjen e thellë me të gjithë ata që kanë humbur më të dashurit e tyre dhe solidarizohemi me pjesëtarët e shërbimeve të emergjencës që janë angazhuar për t'i shpëtuar jetët e njerëzve", thuhet në komunikatën e BE-së.

T'i ndihmojmë Turqisë



PRISHTINË, 6 SHKURT- Publicisti Muhamet Mavraj ka reaguar pas tërmetit prej 7.8-shkallësh të rihterit që goditi Turqinë dhe Sirinë në mëngjesin e së hënës, i cili shkaktoi mijëra viktima dhe mijëra të lënduar. Mavraj ka vënë flamurin turk në fotografinë e profilit në llogarinë e vet në "Facebook" dhe ka kërkuar që Kosova t'i dërgojë njësitë e shpëtimit të FSK-së në Turqi. Mavraj ka përkujtuar edhe një fakt që u vjen vështirë shumë njerëzve ta përmendin: refuzimin e ndihmës së kërkuar për dërgimin e FSK-së në Drenicë dhe Mitrovicë gjatë ditëve të vërshimeve shkatërruese muajin e kaluar.

Postimi i plotë i tij:

Turqia dhe Siria po pësojnë tragjedi nga tërmetet radhazi që nga mëngjesi. Me dhemb zemra për viktimat dhe klithmat nën rrënojat masive. Lutemi për ta me krejt çfarë quhet njerëzillëk brenda njeriut! Kemi një ushtri. Ta tregojmë veten në këtë urgjencë siç bëmë në disa raste jashtë vendit.

P.s.

Ende e ndiej ftohtësinë e fundbarkut që më la pa fjalë: refuzimin për t'u dhënë ndihmën e FSK-së në vërshimet shkatërruese Drenicës e Mitrovicës. Atje është vendlindja e saj.

©

(Komentoni me maturi)

Kosova ofron ndihmë për Turqinë pas tërmetit të fuqishëm

Autoritetet në Kosovë thanë se janë në gatishmëri të lartë dhe në mbështetje e solidaritet me Turqinë pas tërmetit të fuqishëm që la të vdekur qindra persona. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se Kosova është e gatshme ta ofrojë mbështetjen e nevojshme për Turqinë edhe nëpërmjet Forcës së Sigurisë së Kosovës. "Bashkëndiej me të gjithë qytetarët e prekur nga tërmeti shkatërrues në Turqi. Ngushëllimet më të thella për të gjitha jetët e humbura dhe u uroj shërim të shpejtë të gjithë të lënduarve. Solidaritet i plotë me popullin e Turqisë. Republika e

Kosovës është gati ta ofrojë mbështetjen e nevojshme edhe nëpërmjet FSK-së", ka deklaruar Osmani. Ndërkaq, Qeveria e Kosovës ka njoftuar se është duke marrë informata nga Turqia "nëse në qytetet e goditura kemi shtetas tanë dhe t'u ofrojë mbështetjen e nevojshme", thuhet në njoftimin e Qeverisë së Kosovës. Edhe kryeministri Edi Rama ka reaguar pas tërmetit tragjik që goditi Turqinë. "I pikëlluar thellësisht për lajmin e mëngjesit të sotëm për tërmetin shkatërrues që goditi disa pjesë të Turqisë dhe Sirisë. Ngushëllimet tona më të thella për familjet e shumta që humbën jetën dhe u urojmë shërim të shpejtë të lënduarve. Një mision shpëtimit solidariteti do të nis sot për në Turqi", ka thënë Rama.



Shqipëria pret rritje të ndikimit të Kinës në ekonomi

PRISHINË, 6 SHKURT - Në kohën kur Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara kanë shtuar thirrjet për të bërë kujdes ndaj ndikimit të Kinës në Ballkanin Perëndimor, Shqipëria është bërë vendi i dytë në këtë rajon pas Serbisë që ka hequr vizat me shtetin komunist.

Marrëveshja për heqjen reciproke të vizave, e cila është firmosur në mes të muajit janar, do të hyjë në fuqi më 17 shkurt. Një raport i Qendrës për Analizë të Politikave Evropiane (CEPA), i publikuar në gusht të vitit 2022, ka nxjerrë në pah se "Kina kërkon lidhje më të ngushta me Shqipërinë në kuadër të projektit gjigant të Partisë së saj Komuniste për ta zgjeruar ndikimin e Pekinit dhe për t'u bërë aktor kryesor në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropë".

Presidenti i Universitetit Evropian të Tiranës, Selami Xhepa, njohës i çështjeve ekonomike, thotë se marrëveshja për vizat do të ndikojë në këtë synim të Pekinit. "Padyshim që heqja e vizave është një akt mjaft pozitiv për zgjerimin e marrëdhënieve ekonomike e tregtare me Kinën përmes reduktimit të kostove dhe barrierave të lëvizjes. Duhet theksuar se këto barriera edhe para liberalizimit të vizave nuk janë raportuar si pengesë por, sidoqoftë, me heqjen e tyre, supozohet të ketë efekte pozitive", thotë Xhepa për "Radion Evropa e Lirë".

Kina përbën ekonominë e dytë më të madhe në botë pas ShBA-së.

Me gjithë rënien e aktivitetit ekonomik që ka pësuar gjatë pandemisë Covid-19, ajo ka zgjeruar shtrirjen e saj ekonomike dhe tregtare në të gjitha vendet e botës, përfshirë Shqipërinë, thotë Xhepa. "Importet e mallrave kineze [në Shqipëri] janë rritur nga rreth 140 milionë euro në vitin 2005, në mbi 600 milionë euro aktualisht, duke shënuar rritje mbi 5.5 herë. Eksportet e produkteve tona drejt Kinës janë rritur gjithashtu, nga rreth 3 milionë euro në rreth 90 milionë aktualisht. Pra, në një periudhë prej gati një dekade e gjysmë, tregtia e jashtme mes dy vendeve është rritur me ritme mjaft të shpejta", vë në pah Xhepa.

Sipas tij, importet dominohen nga prodhimet e tekstilit, makineritë dhe pajisjet, si dhe produktet e industrisë plastike dhe kimike, ndërsa eksportet i dominojnë produktet minerale. Kina, aktualisht, është partnerja e tretë tregtare e Shqipërisë - pas Italisë dhe Turqisë.

Eksperti i marrëdhënieve ndërkombëtare në Tiranë, pedagogu Dritan Hoti, thotë se vendimi për heqjen e vizave shkon në favor të Kinës, përkatësisht qëllimit të saj për ta



rritur varësinë ekonomike të Shqipërisë ndaj saj. "Heqja e barrierës që përfaqëson sistemi i vizave ndërmjet dy vendeve favorizon më shumë mekanizmat ekonomiko-tregtarë kinezë që të qarkullojnë lirshëm në Shqipëri, duke rritur kështu edhe praninë ekonomike, industriale", thotë Hoti.

Nga ekonomia te ndikimi politik

Veç ndikimit në fushën ekonomike, Hoti sheh rrezik edhe sa i përket ndikimit politik. "Ndryshe nga Rusia, e cila e stigmatizon rolin e botës shqiptare në Ballkan, Kina, duke u qëndruar besnike taktikave të saj të të bërit diplomaci, synon të jetë prezente në Shqipëri, duke i intensifikuar marrëdhëniet dypalëshe. Nisur nga avantazhi i madh, në të gjitha aspektet, që Kina e madhe gëzon përkundrejt Shqipërisë së vogël, bashkëpunimi ekonomik mund të metamorfozohet fare lehtë në një varësi ekonomiko-teknologjike... Kjo varësi mund të shërbejë edhe si një mekanizëm kushtëzues gjeopolitik, i lidhur me çështjen shqiptare", thotë Hoti për Radion Evropa e Lirë.

Bashkimi Evropian po e vëzhgon me kujdes rolin e Kinës në Ballkan. Në samitin e fundit mes BE-së dhe Kinës, që u mbajt në prill të vitit të kaluar, diplomatët evropianë thanë se, në aspektin politik, angazhimi i Kinës nuk është aq i dukshëm sa i Rusisë apo Turqisë. Megjithatë, ai është në rritje dhe kërkon kujdes edhe nga ana e bllokut evropian, thanë ata.

BE-ja dhe Kina janë në grindje për një varg çështjesh - nga spiunazhi ekonomik deri te pozicionimi ushtarak i Pekinit në Tajvan.

Ndonëse ndikimi më i madh i Kinës është vërejtur në Serbi - ku dërgon edhe armë, raketa, kamera të sigurisë e të tjera - ai nuk është i kufizuar vetëm në këtë shtet të Ballkanit.

Një firmë nga Kina është duke ndërtuar urën në Gadishullin Peleshac në Kroaci - projektin më të madh në këtë shtet të BE-së, të financiar nga vetë blloku evropian. Vite më parë, Greqia ia ka shitur Kinës portin në Pire. Edhe Mali i Zi dhe Hungaria kanë projekte të shumta me Kinën. Sipas raportit të Qendrës për Zhvillim Global, Mali i Zi është në mesin e tetë vendeve më të rrezikuara nga prania kineze.

"Ofertat" financiare nga Kina dhe refuzimi nga Shqipëria

Eksperti i ekonomisë, Selami Xhepa, thotë se ka pasur përpjekje të shumta gjatë viteve nga Banka e Kinës për ofrimin e financimeve përmes kredive të buta, të cilat do të kërkonin garanci nga shteti shqiptar. "Qeveritë shqiptare asnjëherë nuk kanë ofruar garanci të tilla, prandaj edhe investimet kineze - ndryshe nga rajoni - nuk kanë pasur sukses. Një nga projektet më ambicioze ishte financimi i Rrugës së Arbrit, për të cilën konkurrentët kinezë siguronin vetë edhe financimin, por nuk u pranuan nga autoritetet tenderuese shqiptare", kujton Xhepa.

Në vitin 2016, një kompani kineze - e mbështetur nga shteti - bleu 100 për qind të aksioneve në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës "Nënë Tereza", por, pak kohë më vonë, marrëveshja u prish.

Në fund të vitit 2019, Shqipëria hoqi dorë edhe nga nënshkrimi i një marrëveshjeje me Kinën për

rjetin e internetit 5G, pas thirrjeve që bëri Ambasada amerikane në Tiranë. Kjo marrëveshje, më pas, u firmos me ShBA-në. Shqipëria është pjesë e nismës 17+1, e iniciuar nga Pekini, e që përfshin vende të Evropës Qendrore, Lindore dhe të Ballkanit Perëndimor. Synim i kësaj nisme është t'i promovojë marrëdhëniet tregtare dhe investuese.

Më herët ka pasur diskutime të gjera nëse Shqipëria do të duhej të dilte prej saj. Por, për ekspertin e ekonomisë, Selami Xhepa, Shqipëria është vetëm formalisht pjesë e saj, pasi, deri më tash, asnjë financim nuk është realizuar në kuadër të këtij projekti. "Nga kjo pikëpamje, dalja e vendit do të ishte një akt që nuk prodhon ndonjë pasojë në termat financiarë, por i tepërt dhe i panevojshëm, si një akt politik, për të cilin nuk ka ndonjë veprim nga partnerët tanë strategjikë, siç janë Bashkimi Evropian apo ShBA-ja", thotë Xhepa. Hoti e sheh pak më ndryshe këtë situatë. "Duhet të vazhdojë të jetë pjesë, por njëkohësisht të tregohet shumë e kujdesshme. Nëse qëndrimi kinez ndaj Kosovës vazhdon të jetë i njëjti - duke e parë atë si realitet të sponsorizuar nga ShBA-ja - mund të shqyrtohet në dritën e rrethanave të reja edhe një largim nga kjo nismë", thotë Hoti.

Shqetësimi që lidhet me ribalancimin e ekonomisë botërore

Të dy ekspertët e shohin përpjekjen e Pekinit për t'u shtrirë në disa sektorë kyç të vendeve të Ballkanit si shqetësuese sa i përket ribalancimit të ekonomisë

botërore. "Për dallim nga Serbia, Mali Zi apo vendet e tjera në rajon, në Shqipëri nuk kemi pasur zgjerim të kapitalit kinez, shtetëror apo privat... Por, investimet kineze kanë krijuar shqetësime në vendet ku kanë depërtuar, pasi kanë krijuar probleme në qëndrueshmërinë fiskale të vendeve përfituese, e për pasojë e kanë thelluar varësinë e tyre nga Kina. Kjo ka rritur qasjen e Kinës në burimet e lëndëve të para të vendeve debitore. Në kontekstin e riformatimit të zinxhirit botëror të furnizimit, që po ndodh pas pandemisë dhe aktualisht luftës në Ukrainë, sigurisht që këto zhvillime ngrënë shqetësime për ribalancimin e ekonomisë botërore", thotë Xhepa.

"Ballkani, si pjesë qendrore e Evropës Juglindore, është i lakmuar si dikur nga perandoritë - ashtu edhe nga Kina aktuale. Kina e projekton pikërisht këtu ndërtimin e një strukture organike të një varësie ekonomiko-teknologjike e industriale", thotë Hoti.

Me hyrjen në fuqi të marrëveshjes për lëvizje të lirë, qytetarët e Shqipërisë do të mund të qëndrojnë pa viza në Kinë deri në 180 ditë.

Qytetarët kinezë e kanë pasur mundësinë për të hyrë me viza turistike në Shqipëri që prej vitit 2019.

Sipas Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në Shqipëri, marrëveshja për lëvizje të lirë do t'i shërbejë forcimit të marrëdhënieve mes dy vendeve.

Më herët, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka deklaruar se vendi i tij pret më shumë investime nga Kina, ndërsa investitorët kinezë kanë shfaqur interesim për investime në energji dhe infrastrukturë.

Bërnabiqi kërkon falje që Kosova u cilësua Republikë: Nuk kam fjetur tërë natën

Beograd, 6 shkurt - Kryeministria e Serbisë, Ana Bërnabiq, tha se në një prej raporteve të publikuara në uebfaqen e qeverisë serbe ishte shkruar Republika e Kosovës, duke shtuar se ky rast kishte të bënte me gabim gjatë përkthimit.

Bërnabiqi tha për Radio Televizionin e Serbisë se gabimi kishte ndodhur në përkthimin në gjuhën angleze. Ajo tha se ky gabim "është i rëndë dhe i pafalshëm i përkthyesit".

Kosova shpalli pavarësinë më 2008, por Beogradi refuzon ta njohë atë. Qëndrimi zyrtar i Serbisë është që Kosova është ende pjesë e saj.

Bërnabiqi tha se përgjegjësi ka edhe ekipi i zyrës për medie në qeverinë serbe, prandaj ajo shtoi se do të ketë pasoja për punëtorët që lëshuan këtë gabim.

Kryeministria serbe tha se kjo përmbajtje është larguar menjëherë nga uebfaqja e qeverisë serbe. "Nuk mund të flija mbrëmë. Nuk e di se çfarë po bëj. Por, më vjen keq që kjo po përdoret nga opozita për të fituar poenë politike", tha Bërnabiqi.

Kryeministria serbe, po ashtu, foli edhe për vizitën e planifikuar për 6 shkurt të të dërguarit të Bashkimit Evropian, Miroslav Lajçak, në Prishtinë dhe Beograd. Ajo tha se aktivitetet e tilla diplomatike po shtohen, gjithashtu edhe presioni, duke shtuar se beson në garancitë e komunitetit ndërkombëtar sa i përket themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Kryeministria serbe tha se palët janë pajtuar që të formohet Asociacioni në kuadër të marrëveshjeve të arritura në Bruksel më 2013 dhe 2015 dhe theksoi se beson në



garancitë e komunitetit ndërkombëtar se Asociacioni do të formohet në bazë të marrëveshjeve të arritura në dialog. Kosova kundërshton

themelimin e një asociacioni njëetnik, duke shprehur frikën se mund të krijohet një Republika Sërpska ashtu sikurse në Bosnjë-Hercegovinë. ShBA-ja dhe BE-ja po kërkojnë

që Kosova t'i zbatojë marrëveshjet për Asociacionin. Uashingtoni ka shprehur qartë se është kundër themelimit të një asociacioni që do t'i ngjasonte Republikës Sërpska.

PDK-ja po vazhdon zgjerimin në mërgatë, themelon tri nëndegë në Itali



PRISHTINË, 6 SHKURT - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) po vazhdon zgjerimin në mërgatë. Kryetari i Komisionit për Organizimin e PDK-së në Mërgatë, Elmi Reçica, nënkryetarja Vlora Çitaku dhe nënkryetari i Kuvendit nga radhët e PDK-së, Enver Hoxhaj, kanë qëndruar këtë fundjavë në Itali, ku kanë marrë pjesë në themelimin tri nëndegëve të PDK-së në Itali.

Në Kuvendin Zgjedhor të mbajtur në Bassano Del Grappa të Italisë, kryetar u zgjodh Sahit Topalli, ndërsa biznesmeni i suksesshëm Sefer Buzhala u zgjodh kryetar i nëndegës së PDK-së në Padova, kurse Lirim Kolgeci do ta udhëheqë nëndegën në Treviso.

Kryetari i Komisionit për

Organizimin e PDK-së në Mërgatë, Elmi Reçica, ka njoftuar që së shpejti do të mbahet Kuvendi Zgjedhor për Degën e PDK-së në Itali.

"Vizioni i Partisë Demokratike të Kosovës është që të krijojë mundësi të reja të shfrytëzimit të potencialit të madh intelektual dhe atij kapital të mërgatës sonë në të mirë të zhvillimit dhe kthimit të dinjitetit të qytetarit të Kosovës. Uroj dhe përgëzoj themelimin e nëndegës, zgjedhjen e kryetarit dhe të kryesisë. Me këtë dinamizëm së shpejti pritet të mbahet Kuvendi Zgjedhor për Degën e PDK-së në Itali. Partia Demokratike e Kosovës do të jetë gjithmonë pranë qytetarëve tanë në mërgatë", ka theksuar Reçica.

Vitia në koordinim me partnerët e rëndësishëm në sektorin e shëndetësisë për kujdesin emergjent

Prishtinë, 6 shkurt - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia dhe zëvendësministria Dafina Gexha-Bunjaku mbajtën takim me radhës në platformën elektronike "Zoom" për t'i bashkërenduar aktivitetet me partnerët e rëndësishëm në sektorin e shëndetësisë, siç është "MASHAV Cooperation".

Gjatë këtij takimi u bisedua për kujdesin emergjent si një prej shërbimeve vitale në sektorin e shëndetësisë. Në kuadër të këtij bashkëpunimi u fol për mundësitë e trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve ekzistuese në kujdesin emergjent.

Ditë më parë ministri Vitia takoi

ambasadoren e shtetit të Izraelit në Republikën e Kosovës, Tamar Ziv, me të cilin diskutoi për raportin me të gjetura dhe rekomandime lidhur me ofrimin e shërbimeve emergjente, me ç'rast shteti i Izraelit ka shprehur gatishmërinë për përkrahje në fushën e trajnimit dhe avancimit të stafit shëndetësor.

"MASHAV Cooperation" është programi zyrtar i bashkëpunimit ndërkombëtar i Izraelit për zhvillim, me synimin për të ndarë me pjesën tjetër të vendeve në zhvillim përvojën e shtetit të Izraelit për ekspertizën, trajnimet, teknologjitë inovative dhe metodologjitë e testuara.



Lansohet platforma “superpuna”, synohet punësimi i 10 mijë të rinjve


EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 SHKURT - Kryeministri Albin Kurti ka marrë pjesë në lansimin e platformës “superpuna”, e cila mbështetë sektorin privat në krijimin e vendeve të reja të punës për të rinjtë e moshës 18-25 vjeç.

Subvencioni i qeverisë do të jetë në nivelin 264 euro/muaj, për 6 muaj me radhë, ndërsa punëdhënësi mund të shtojë edhe mbi këtë shumë.

Kurti ka thënë se qeveria e drejtuar nga ai në vazhdimësi ka hartuar e përkrahur politika të cilat synojnë nxitjen e punësimit dhe qasje më të lehtë në tregun e punës. Kryeministri ka theksuar se lansimi i platformës “superpuna”, angazhim i kamotshëm i ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, është njëkohësisht edhe konkretizim i përkushtimit të qeverisë në rritjen e punësimit të të rinjve dhe mbështetjen e punëdhënësve tanë si dhe e shënon përbushjen edhe të një tjetër premtimi për qytetarët e Republikës. “Vitin e kaluar kemi zbatuar skema të cilat kanë pasur synim punësimin e grupeve të ndryshme shoqërore: gratë, personat me aftësi të kufizuar, familjet të cilat nuk kanë asnjë anëtar të



punësuar. Përmes masës 1.3 u punësuan afër 5 000 gra e vajza. Përmes masës 1.6 u punësuan 239 persona me aftësi të kufizuar. Ndërkaq përmes skemës ‘Qeveria për familjet’, 770 familje u bënë me një anëtar të punësuar. Nga sot po fillojmë pilotimin e Skemës së Punësimit të Garantuar për të Rinjtë. Nëpërmjet saj, Qeveria do të subvencionojë 264 euro në lartësinë e pagës minimale që ka kaluar në lexim të parë në

Kuvendin e Republikës së Kosovës për 6 muajt e parë të punësimit”, ka thënë Kurti. Duke u ofruar të rinjve mundësinë për të fituar përvojë të vlefshme pune dhe për t’i zhvilluar aftësitë e tyre, Kurti ka thënë se qeveria po ndërton një fuqi punëtore të aftë, e cila do ta rrisë ekonominë e vendit. “Ndërkohë, po vazhdojmë mbështetjen ndaj sektorit privat në angazhimin e fuqisë së re punëtore, e cila ka të

gjithë potencialin që të bëhet motore e zhvillimit të këtij sektori. Rininë e kemi aset të së tashmes. E kemi edhe potencial të së ardhmes. Kujdesi, vëmendja dhe investimi ynë në ta sot, është angazhimi, kontributi dhe investimi i tyre në vendin tonë nesër. Më lejoni t’i falënderoj të gjitha ata të cilët kanë kontribuar dhe ndihmuar në finalizimin e kësaj ndërmarrjeje, veçanërisht Ambasadën e Zvicrës në

Kosovë”, ka deklaruar Kurti. Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka deklaruar se qeveria synon të punësojë rreth 10 mijë të rinj brenda vitit të parë të lansimit të platformës “superpuna”. Ai i ka ftuar të gjithë punëdhënësit që të përfitojnë nga kjo mundësi, duke shpallur pozitën e lira përmes platformës “superpuna”. “I tërë procesi është objektiv dhe i automatizuar”, ka theksuar ministri Murati.

Ministria e Infrastrukturës: Të gjitha rrugët janë të kalueshme në Kosovë



PRISHTINË, 6 SHKURT - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka njoftuar se të gjitha rrugët nacionale, rajonale dhe autoudhët janë të mirëmbajtura dhe të kalueshme për qarkullim rrugor. Në disa segmente, siç ka informuar MI-ja, si rezultat i reshjeve të fundit të borës dhe sidomos i erërave, përkatësisht në rrugën Kerpimëh - Bajgorë, ka pasur pengesa të përkohshme në rrugë, por është intervenuar

dhe rruga është hapur për qarkullimin e automjeteve. “Ekipet tona janë në kujdestari 24-orëshe dhe janë duke intervenuar me hedhje të kripës dhe aktivitetet e tjera të nevojshme për mirëmbajtjen e rrugëve, aty ku ka më shumë reshje që të bëhen të kalueshme dhe të sigurta, megjithatë një kujdes i shtuar në vozitje dhe përshtatja me kushtet atmosferike është e domosdoshme”, ka njoftuar Ministria e Infrastrukturës.

Dhoma e Tregtisë emëron drejtoreshën ekzekutive

PRISHTINË, 6 SHKURT - Bordi i Drejtorëve i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës (DhTIK) ka emëruar Zana Beqirin drejtoreshë ekzekutive e DhTIK-së. Zana Beqiri është juriste me profesion dhe vjen me një përvojë mbi 22 vjet menaxhim

vendor dhe ndërkombëtar si dhe ka udhëhequr projekte të ndryshme emergjence dhe ato zhvillimore ndërkombëtare në nivel qendror, regional dhe më larg. “Kjo përvojë e ndërlidhur me një numër të madh sektorësh do ta ndihmojë DhTIK-në në

ritjen dhe zhvillimin edhe me të madh të Dhomës në shërbim të bizneseve dhe rritjen e kontributit për përmirësimin e infrastrukturës ligjore të vendit tonë. Zana Beqiri është emëruar me mandat trevjeçar”, ka njoftuar DhTIK-ja.



“Republika” e Platonit ishte një makth totalitar, jo një utopi



Nga Scotty HENDRICKS

Letërsia dhe filozofia, janë të mbushura me vizione të utopisë, të shkruara nga mendimtarë që i përkasin rrymave të ndryshme ideologjike. Disa prej tyre bazohen në sisteme alternative ekonomike; të tjerët i përshtaten një pikëpamje specifike të psikologjisë njerëzore; dhe të tjerë akoma shpresojnë të gjejnë harmoni me natyrën. Si gati në çdo fushë tjetër të përpjekjeve intelektuale, të gjithë ata i detyrohen shumë Platonit, që e bëri i pari. Libri “Republika” i filozofit të Greqisë së Lashtë përmban skicën e parë të njohur mbi një shoqëri utopike. Pjesërisht një alegori, pjesërisht një propozim politikash legjitime, dhe pjesërisht kritikë e sistemeve ekzistuese, libri ofron shumë ide që flasin mbi një qytet ideal. Por për fat të keq siç do ta shohim së shpejti, askush nuk do të dëshironte të jetonte atje.

Utopia e parë

Shumica e letërsisë utopike fillon me përpjekjen për t’i dhënë përgjigje pyetjes “Çfarë është shoqëria ideale?”. “Republika” e Platonit fillon duke u përpjekur t’i përgjigjet pyetjes: “Çfarë është drejtësia dhe a është mirë që një person të jetë i drejtë?”. Kjo është një pyetje shumë e rëndësishme,

dhe Platoni i përgjigjet asaj me analogji nëpërmjet personazhit të tij kryesor Sokratit.

Ai thotë se drejtësia në qytetin ideal, është e ngjashme me drejtësinë e një personi dhe duke e kuptuar drejtësinë në shkallën më të madhe dhe më të lehtë për t’u parë, ne mund ta kuptojmë atë në shkallën më të vogël. Qyteti, i quajtur Kalipolis, do të qeverisej nga mbretër-filozofë.

Të zgjedhur për mençurinë e tyre, këta sundimtarë do të arsimoheshin për 50 vjet përpara se të merrnin kontrollin e qytetit. Të udhëhequr nga kuptimi i tyre për të mirën, të drejtën dhe mënyrën se si ta arrinin atë, ata do ta çonin qytetin drejt paqes dhe prosperitetit.

Burrat dhe gratë do të trajtoheshin në mënyrë të barabartë, pasi Platoni nuk mund të gjejë asnjë arsye pse gratë mund të mos jenë në gjendje të bëjnë atë që bëjnë burrat brenda kufijve të arsyeshëm. Të gjithë fëmijëve do t’u jepej një arsim cilësor i përshtatshëm për talentet e tyre natyrore.

Dhe kjo fundit do të orientohej drejt krijimit të qytetit më të mirë të mundshëm, me lumturi, virtyte dhe një harmoni të niveleve të larta, ose të paktën siç e konceptoi Platoni. Qyteti do ta arrinte këtë gjë nëpërmjet një serie gjithnjë e më totalitare ligjesh dhe rregulloresh, që do të garantonin funksionin e tij, pa marrë shumë parasysh dëshirat e deklaruar të

popullatës.

Ndërsa shumë nga specifikat janë lënë të padeklaruara, ajo që thuhet është e bollshme. Qyteti përmbante një sistem kastash të ngurtësuar, ku nuk lejoheshin ndryshime sociale të mundshme për të rriturit. Megjithatë, fëmijët e tyre mund të gradoheshin ose uleshin në detyrë në bazë të mënyrës se si paraqiteshin në shkollë.

Shtesa e gardianëve dhe e luftëtarëve që e sundonin dhe mbronin qytetin, do të ishte pa prona personale dhe private, duke jetuar në vendbanime komunale të financuara nga taksat e mbledhura nga shtresat e ulëta. Të gjithë sundimtarët do të zgjidheshin nga kjo klasë.

Ndërkohë familjet nuk do të ekzistonin më si njësi të vetme. Në vend të kësaj, fëmijët e lindur nga martesat e sanksionuara nga shteti do të rriteshin nga shteti. Krahas kësaj do të ishte në fuqi një sistem eugenik që lejonte vrasjen e foshnjave që lindin nga “prindër inferiorë” ose kromozome “me defekt”.

Po ashtu, do të përdroreshin disa manipulime, për t’u siguruar që prindërit me cilësi më të ulëta të mos kontaminonin linjat e gjakut të njerëzve me cilësi më të lartë. Për të garantuar respektimin e së vërtetës, të gjithë poetët duhet të dëboheshin nga vendi.

Të gjitha veprat e kulturës, nga dramat deri tek tregimet që u tregohen fëmijëve para gjumit, do

të miratoheshin nga pushtetarët. Natyrisht, këta sundimtarë janë të vetmit njerëz të aftë për të kuptuar “të vërtetën” në vend të imitimeve të saj surrogato.

Sistemi do të rezistonin falë një “gënjeshtrë fisnike”, duke i siguruar njerëzit e thjeshtë se shpirtat ndahen në disa kategori. Mbretërit filozofë kanë një shpirt të artë, ndihmësit dhe luftëtarët e tyre kanë një shpirt të argjenditë, ndërsa fermerët, punëtorët dhe mjeshtrit janë bërë metafizikisht prej bronzi dhe hekuri.

Gënjeshtra përfshin paralajmërimin se gjithçka do të shembet nëse në krye do të vihen njerëz të ndërtuar keq. Dhe ajo është e destinuar të dështojë, siç sugjeron Platoni për të gjitha regjimet politike. Tingëllon këndshëm, apo jo?

Filozofi Karl Popper, kundërshtimet e të cilit ndaj totalitarizmit janë shfaqur në disa nga librat e tij, mendonte se idetë e shfaqura në “Republika” e Platonit ishin marrë shumë seriozisht. Me përkushtimin e tij ndaj idesë se inxhinieria sociale nuk është e mundur, por shpeshherë edhe e dëshirueshme, dhe se gjithçka është e lejuar për sa kohë që politika drejtohet drejt së mirës “objektive”, Popper sugjeron se libri i Platonit frymëzoi intelektualisht lëvizjet totalitare të shekullit XX-të.


Vetë Ajatollah Khomeini, themeluesi i Republikës Islamike të Iranit dhe udhëheqësi i

Revolucionit Iranian, u frymëzua nga ky libër kur themeloi qeverinë e re iraniane, së bashku me mbretin-filozof. Se sa mirë funksionoi kjo gjë mbetet ende një subjekt debati.

Filozofi Bertrand Rasëll, një tjetër kritik i librit në fjalë, argumentoi se libri kishte predispozitë të merrej seriozisht si një shoqëri që mund të krijohej në Greqinë e lashtë. Ndërkohë çdo ide e utopisë – moderne apo e lashtë – do të bazohet tek supozimet për njerëzit, shoqëritë, drejtësinë dhe koncepte të tjera që dikush tjetër do t’i konsiderojë të diskutueshme.

Nga 2000 vite para kur Platoni shkroi librin tij, gjithçka që ai tha është shndërruar nga një libër i saktë në një vizion absurd. Rrjedhimisht, qyteti i tij i përsosur na duket sot monstruoze. Megjithatë, diskutimi i nxitur nga debati nëse Kalipolis i Platonit është ideal, praktik apo edhe i mundshëm, e ka çuar përpara kuptimin tonë mbi etikën dhe filozofinë politike.

Tek e fundit, ne duhet të pyesim veten pse na pëlqejnë konceptet si liria dhe demokracia kur përballemi me një alternativë që supozohet se na ofron një shoqëri më të mirë. Si gjithmonë, ne mund t’i detyrohemi Platonit një falënderim, edhe pse në përgjithësi e refuzojmë filozofinë e tij. / *Big Think – Bota.al*



Veton Zymberi, redaktor i sportit

Premtohet festë e basketbollit në Rahovec



PRISHTINË, 6 SHKURT - Në zyrat e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) është organizuar konferenca për medie lidhur me Final 8 Kupës së Kosovës. Kjo ngjarje do të organizohet në Rahovec nga 15 deri më 19 shkurt, ku do të garojnë tetë klubet e elitës së meshkujve, finalja e femrave, si dhe katër klubet më të mira të Ligës së Parë të meshkujve. Adriatik Rraci, menaxher i Përfaqësuesve të Kosovës në FBK, është shprehur se FBK-ja do të ndihmojë klubin organizator dhe do të bëjnë çmos që ky event të jetë spektakël i basketbollit. “Stafi i FBK-së edhe kësaj radhe do ta

ndihmojë klubin organizator dhe do të bëjë përpjekje maksimale që kjo ngjarje e basketbollit të jetë spektakël, ashtu siç i ka hije Kupës së Kosovës, një event shumë i rëndësishëm për basketbollin e Kosovës. Ne (FBK) jemi të nderuar që ky organizim do të mbahet në Rahovec dhe besojmë se do të organizohet në mënyrën më të mirë të mundshme”, ka thënë Rraci. Ndërsa Adrian Sharku, përfaqësues i Rahovecit, ka theksuar se nga 15 deri më 19 shkurt do të zhvillohet spektakël i basketbollit. “Kjo është hera e tretë që organizojmë Final 8 në pesë vjet dhe ky është nder e privilegj për ne. Kësaj radhe do të

mbahet edhe përgjatë Festës së Pavarësisë së Kosovës, duke e madhështuar edhe më shumë këtë ngjarje. Ne i ftojmë tifozët nga të gjitha qytetet që të vijnë dhe ta shijojnë festën e basketbollit. Kemi traditë mikpritjen dhe besojmë se do të jetë një festë e basketbollit nga 15 deri më 19 shkurt”, ka deklaruar Sharku, duke zbuluar edhe logon e kësaj ngjarje, që simbolizon qytetin e Rahovecit, tetë klubet pjesëmarrëse dhe flamurin e Kosovës. Ai shtoi se shumë shpejt do të publikohen edhe çmimet e biletave për Final 8. Në fund u nënshkrua marrëveshja mes dy palëve.

SHKURT

FC Prishtina kualifikohet në çerekfinale të Kupës

FC Prishtina është kualifikuar në çerekfinale të Kupës, pasi e ka mposhtur Dukagjinin me rezultat 3-1 në ndeshjen e vlefshme të së tetës së finales së Kupës së Kosovës. Kryeqytetasit shkuan në pushim me dy gola epërsi të cilat i shënuan Leotrim Kryeziu dhe Jalen Blesa. Ky i fundit e shënoi edhe një gol në pjesën e dytë. Nga ana tjetër, golin e vetëm e shënoi Vladislav Khomutov. Prishtina kështu e kompletonte fazën çerekfinale të kësaj gare.

Sulmohet Faruk Statovci

Ish-futbollisti i njohur dhe trajneri i Përfaqësueses U15 në futboll, Faruk Statovci, është sulmuar në afërsi të banesës së tij në Prishtinë. Pas këtij sulmi ka reaguuar edhe Federata e Futbollit e Kosovës e cila e ka dënuar dhunën e ushtruar ndaj trajnerit Statovci. Sipas FFK-së, një ngjarje e tillë e rëndë e ka goditur jo vetëm familjen Statovci, por edhe komunitetin e futbollit në tërësi. Ndërsa vetë Statovci ka konfirmuar se ka marrë trajtimin në QKUK dhe se lëndimet e marra janë të vogla dhe joserioze.

Arti, më i miri i javës në elitën e basketbollit

Xhiroja e 21-të në elitën e basketbollit solli përballje mjaft interesante. Peja fitoi ndaj Rahovecit, por më vështirë se që është pritur, ndërsa te pejanët më i miri ishte Arti Hajdari. Arti momentet vendimtare nuk dështoi, ku shënoi gjashtë herë për tri pikë nga tetë tentime, kurse pesë herë për dy pikë nga shtatë tentime, duke qenë basketbollisti më i mirë i ndeshjes dhe i kësaj jave në elitë. Sigal Prishtina regjistroi fitoren e radhës në elitë, ku u dallua dyshja Brooks Debisschop me 16 pikë, 15 kërcime e katër asistime dhe Dustin Thomas me 16 pikë, 16 kërcime dhe dy asistime. Golden Eagle Ylli u kthye te fitoret, ku mundi Bashkimin, ku më i miri te kampionët e Kosovës ishte kapiteni Gëzim Morina me 23 pikë, shtatë kërcime dhe tre asistime. Trepça regjistroi fitore të rëndësishme në Gjakovë ndaj Vëllaznimit, ndërsa më i dalluari ishte Drilon Hajrizi me 20 pikë, katër kërcime dhe tre asistime.

Mundësit e rinj të Kosovës i shpëtuan tërmetit në Turqi

PRISHTINË, 6 SHKURT - Tërmeti i fuqishëm që e goditi Turqinë i ka përfshirë edhe disa sportistë kosovarë. Hoteli ku gjendej ekipi i mundësve të rinj të Kosovës u dëmtua nga ky tërmet i tmerrshëm por, fatmirësisht, ata janë shëndosh e mirë dhe u kanë

ndihmuar njerëzve nën gërmadha. “Ekipi i Federatës i Mundjes së Kosovës, pjesëmarrës në turneun ndërkombëtar ‘12 February’ në Kahramarash të Turqisë, falë Zotit i shpëtoj më të keqes nga tërmeti katastrofal 7.7 shkallë. Të gjitha objektet afër

hotelit ku ishte i vendosur ekipi i FMK-së janë rrafshuar përtokë. Mundësit tanë treguan heroizëm të paparë duke u ndihmuar njerëzve në gërmadha. Ekipi i FMK-së për momentin është vendosur në qytetin Kajseri”, thuhet në njoftimin e FMK-së.



Federeri: Karriera ime ka përfunduar

Cyril, 6 shkurt - Tenisti zviceran Roger Federer, në një intervistë për CNBC, ka rrëfyer se ka marrë mjaft oferta nga disa turne për të luajtur sërish pavarësisht se u tërhoq nga sporti në shtatorin e vitit të kaluar. Pesë muaj pasi i ka thënë

“lamtumirë” karrierës në turneun e Laver Cup, fituesi i 20 grand slameve sqaron të ardhmen e tij. “Nuk jam fans i rikthimeve. Kur mora vendimin për t’u tërhequr kam reflektuar gjatë dhe e dija që nuk do të kthehesha më për të luajtur

tenis. Nuk jam penduar për zgjedhjen që kam bërë, pasi e di që e kam shtrydhur mirë limonin deri në pikën e tij të fundit”, u shpreh Roger Federer. “E them me gojën plot se karriera ime ka përfunduar. Problemet në gju i bënë shumë

të vështira vitet e fundit të karrierës time, nuk e mohoj këtë gjë. Nëse para katër vjetësh do të më thoshin se do të bëja tri operacione në gju do të vija duart në kokë”, u shpreh Federeri, që vijon të stërvitet sa herë që ka kohë.



Publikohen shkeljet që i ka bërë Manchester City brenda dhe jashtë Premierë Ligës

MANCHESTER, 6 SHKURT - Manchester City është akuzuar nga Premierë Liga për shkelje të shumta financiare. Hetimi filloi në dhjetor 2018 pasi dokumentet u publikuan nga faqja e internetit hulmues “Football Leaks,” të publikuara më pas nga gazeta gjermane “Der Spiegel”. Aty pretendohet se City kishte mbivlerësuar të ardhurat nga sponsorizimi, duke dyfishuar në mënyrë efektive pagat e ish-trajnerit Roberto Mancini nëpërmjet një kontakti të fshehtë me një klub të Abu Dabit dhe thyer rregullat mbi qasjet ndaj lojtarëve të rinj. Ata tani janë goditur me më shumë se 100 akuzat për shkelje të rregullave financiare midis shtatorit 2009 dhe fundit të sezonit 2017-18. Premierë Liga zbuloi se ata e kanë akuzuar Cityn për një sërë shkeljes nga viti 2009 deri në vitin 2018. “Në përputhje me Rregullën W.82.1 të Ligës Premierë, liga konfirmon se ka referuar sot një numër shkeljesh të supozuara të Rregullave të Ligës Premierë nga Klubi i Futbollit Manchester City të një Komisioni sipas Rregullit W.3.4 të Ligës Premierë”, thuhet në



deklaratën e tyre. “Komisionet janë të pavarura nga Liga Premierë dhe klubet anëtare. Anëtarët e Komisionit do të emërohen nga kryetari i pavarur i Kolegjit Gjyqësor të Ligës Premier në përputhje me Rregullat W.19, W.20 dhe W.26 të Ligës Premierë”. “Procedurat para Komisionit, në përputhje me Rregullën W.82 të Ligës Premierë, do të jenë konfidenciale dhe do të dëgjohen privatisht. Sipas Rregullës W.82.2 të Ligës Premierë, vendimi përfundimtar i Komisionit do të publikohet në faqen e internetit të Ligës Premierë”. “Ky konfirmim

është bërë në përputhje me Rregullën W.82.1 të Ligës Premier. Liga nuk do të bëjë komente të mëtejshme në lidhje me këtë çështje deri në një njoftim të dytë”, përfundon njoftimi i tyre. Sipas Martyn Ziegler i “The Times”, City mund t’i jepet një zbritje pikësh nëse vërtetohen shkeljet. Përjashtimi nga liga është gjithashtu i mundur. City pati sukses të madh nga shtatori 2009 deri në fund të sezonit 2017-18. Në atë hark kohor, ata fituan tre tituj të Premierë Ligës, u kurorëzuan fitues të FA Cup në 2011 dhe fituan Kupën Carabao tri herë.

Zhgenjëjnë Denveri, Memphis dhe Philadelphia

Memphis, 6 shkurt - Ekipi i Denverit ruan kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit pavarësisht prej humbjes së thellë pësuar ndaj Minnesotas me rezultatet 128-98. Një ndeshje ku kolektiviteti i ekipit vendës bëri diferencën në fushë, me 56 pikë që u realizuan nga lojtarët e stolit. Te Denveri u ndje mungesa e Nikola Jokiqit. Fiton edhe New Yorku, që mundi me rezultat 108-97 Philadelphia, duke konsoliduar pozitën në zonën “play-off”. Randle me 24 pikë e Brunsoni me 21 bënë diferencën për njujorkezët, duke i bërë të pavlefshme 31 pikët e 14



reboundet e Joel Embiidit për miqtë. Në ndeshjet e tjera, Orlando mundi 119-113 Charlotten, ndeshje ku u dallua Bancharo me 22 pikë e 10 rebounde. Toronto, falë

kolektivitetit (7 lojtarë mbi 10 pikë), mundi 106-103 Memphisin, ndërsa Clevelandi fitoi me rezultat 122-103 në fushën e Indianas (Garland 24 pikë).

REZULTATET

Charlotte - Orlando	113-119
Indiana - Cleveland	103-122
New York - Philadelphia	108-97
Memphis - Toronto	103-106
Minnesota - Denver	128-98
New Orleans - Sacramento	136-104

Curry mungon dy muaj

Basketbollisti i Golden State Warriorsit, kapiteni Stephen Curry, do të qëndrojë të paktën dy muaj pushim pas lëndimit që pësoi në ndeshjen ndaj Dallas Mavericks. Ai la në mes

ndeshjen në periodën e tretë, ndërkohë që analizat e kryera kanë evidentuar një dëmtim të rëndë. Sipas medieve amerikane, pas kryerjes së rezonancës magnetike, Curry ka një

lëndim në ligamentet e këmbës së majtë. Lajmi është konfirmuar më pas edhe nga vetë skuadra (27 fitore, 26 humbje këtë sezon), që ka shtuar se gjendja e basketbollistit 34-vjeçar do të

monitorohet herë pas here për ta përcaktuar edhe datën e saktë të rikthimit të tij. Një dëmtim që vjen në një moment jo të mirë të ekipit kampion të NBA-së. Ky është dëmtimi i dytë që pëson

Curry këtë sezon, më i rëndë se ai i dhjetorit, ku qëndroi tri javë pushim. Këtë herë ai do të mungojë më gjatë dhe vështirë se Warriorsi këtë sezon mund ta mbrojë titullin.

SHKURT

Legjenda e portës turke shpërthen në lot: Na ndihmoni, për hir të Allahut!

Legjenda e portës së Turqisë dhe klubit Fenerbahçe, trajneri aktual i klubit turk Hatayspor, Volkan Demirel, ka kërkuar ndihmë mes lotëve në një video live në rrjetin social. “Të gjithë janë të mjerë këtu. Të gjithë po vdesin në Hataj. Ju lutem dërgoni ambulancë, ndihmoni këtu. Kushtet janë shumë të këqija. Ndhmoni, nuk mund t’i arrijmë njerëzit. Nuk mund të bëjmë shumë vetë. Dua që t’i dërgoni të gjitha nëse është e mundur. Ju lutemi ndihmoni për hir të Allahut!”, është shprehur i dëshpëruar ish-portieri i Fenerbahçes. Turqia është goditur nga një tërmet tepër i fuqishëm në orët e para të mëngjesit të ditës së sotme, ku kjo fatkeqësi natyrore ka shkaktuar qindra humbje jete deri më tani dhe mbi 2 mijë të plagosur.

Ancelotti: Humbje e rëndë, e pamerituar

Real Madridi pësoi një goditje të fortë në garën për titull. Ekipi i Carlo Ancelottit pësoi humbje ndaj Mallorcas. “Një disfatë e rëndë, shumë e vështirë. Nuk kishim fat ta administronim si duhej, pësuam edhe një gol të shpejtë. Meritonim të paktën një barazim, gabuam një penallti, ndërsa nuk shfrytëzuam mirë disa raste”, ka thënë trajneri Carlo Ancelotti. Pas kësaj humbje të Realit ka përfutur Barcelona që e mposhti Sevillën dhe shkoi në tetë pikë diferencë nga vendi i dytë, Real Madridi.

Gjashtë futbollistë pritet të largohen nga Unitedi

Skuadra e Manchester Unitedit pritet t’i largojë gjashtë futbollistë në afatin kalimtar të verës. Sipas “Mirror”, trajneri Ten Hagen planifikon një eksod masiv në fund të sezonit. Kapiteni Harry Maguire mund të jetë i pari që do të largohet, pasi nuk ka treguar formë të mirë për një kohë të gjatë. Në listë janë edhe Erick Bailly me Alex Telles, ndërsa nuk mungojnë edhe mesfushorët McTominay dhe Donny van de Beek si dhe anësori ofensiv Anthony Martial.

Guardiola: Nuk jemi në gjendje të mendojmë për titullin

Tottenham Hotspuri ka arritur të triumfojë me rezultat minimal 1-0 ndaj Manchester Cityt, fitore kjo që “dëmton” shumë rrugën e “qytetarëve” drejt titullit kampion. Një gjë të tillë e ka konfirmuar dhe vetë trajneri i “qytetarëve”, Pep Guardiola. “Ne patëm një fillim loje të shkëlqyeshëm, siç ndodh shpesh kundër Tottenhamit, por u ndëshkuam nga një gabim. Në 0-1 është një lojë ndryshe. Ne kishim shanse, por sigurisht që është e vështirë të luash kundër Son dhe Kulusevski kur humbet topin në fazat kalimtare. Humbëm tri pikë. Lojtarët e ndoqën planin në pjesën më të madhe, por nuk është e lehtë të luash kur kundërshtari mbrohet me dhjetë lojtarë dhe ulet në mbrojtje pak më shumë se në ‘Etihad’ dy javë më parë. Ne luajtëm mirë, sidomos në fillim”, ka thënë Guardiola. “Herët a vonë statistikave tona në stadiumin e Tottenham Hotspurit do të ndryshojnë, por është e çuditshme që ne nuk shënuam kurrë. Është e vështirë të gesh një shpjegim. Tani nuk jemi në gjendje të mendojmë për kampionatin. Mendojmë vetëm për ndeshjen e radhës kundër Aston Villas. Ne do të përgatitemi mirë dhe do të luajmë sa më mirë”, ka shtuar Guardiola.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Avokati Fitim” SH.P.K. me pronar Fitim Limani Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811922922 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Avokati Fitim” D.O.O. Fitim Limani Gnjilan, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811922922 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Avokati Fitim” L.L.C. Fitim Limani Gjilan, has come to the decision to quit its business: 811922922 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Gjeoteknika” SH.P.K. me pronar Nevzad Piraj Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810679897 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Gjeoteknika” D.O.O. Nevzad Piraj, Gnjilan, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810679897 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Gjeoteknika” L.L.C. Nevzad Piraj Gjilan, has come to the decision to quit its business: 810679897 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Madame Cosmetics” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811912915 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Madame Cosmetics” D.O.O. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811912915 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Madame Cosmetics” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811912915 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Autolarje Doni shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues 810890930.

- Eskont L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues 810140335.

- Granit Sylejmani shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Sami Frashëri” Prishtinë.

- Ora Travel SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811467168.

- Gabriell Prenkaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjiminazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Nora Ahmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl I te sh.m. Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Jozef Tunprenkaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu “Don Shtjefen Kurti” Novosell e Epërme nga kl.I-V dhe VI-IX

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues